



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE “IBËR - LEPENC” SH.A.

HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE “IBËR - LEPENC” J.S.C.

VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE “IBËR - LEPENC” D.D.

Sheshi ”Bil Clinton” Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar ”Bil Clinton” Br.13 Priština, Kosovo  
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: [info@iber-lepenc.org](mailto:info@iber-lepenc.org)

Në përputhje me nenin 10 paragrafi 2, pika 2.3, dhe nenin 11 paragrafi 1, të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më dt. 01.12.2010, në bazë të funksioneve dhe kompetencave që parashihen me nenin 17 paragrafi 1, 2 dhe 3 i Statutit të Ndërmarrjes Hidroekonomike ”Ibër-Lepenc” Sh.A., si dhe mbështetur në Udhëzimin Administrativ MFPT Nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, NPH ”Ibër-Lepenc” Sh.A. publikon këtë:

## KONKURS PUBLIK

**Për plotësimin e një (1) pozite**

**Titulli i punës: Inxhinier i Makinerisë - (**Numrl i kryeresve 1**)**

**Vendi: Njësia Punuese ”Shkabaj”**

**Ndërmarrja: Ndërmarrja Publike Hidroekonomike ”Ibër Lepenc” Sh.A**

**Niveli i pages: 520 poena**

**Detyrat dhe përgjegjësite e punës:**

- Koordinon punën e tij me inxhinierin për punë të elektros dhe me personelin tjeter në SHEM, me qëllim të funksionimit sa më të suksesshëm të instalimeve dhe pajisjeve elektromakinerike;
- Mbanë evidencën dhe përgjigjet për rregullsinë e tërë pajisjeve dhe instalimeve si dhe për gjendjen e akumulimit të ujit;
- Punon dhe përgatitë planin ditor, favor dhe mujob të punës si dhe planin e riparimit të rregullt vjetor;
- Udhëheq dhe aplikon tërë dokumentacionin teknik (skemat hidraulike udhëzimet dhe normat teknike) i aplikon, përpunon dhe të njëjtat ia dërgon personelit në përdorim;
- Merr pjesë në riparim si dhe zbaton masat e MHT në punë;
- Kryen edhe punë tjera sipas urdhrit të shefit të shërbimit SHEM;
- Për punën e tij i përgjigjet Shefit të shërbimit dhe drejtorit të departamentit;

**Aftësitë dhe kualifikimet:**

- Edukimi universitar, Fakulteti Inxhinieri Mekanike;
- Së paku 3 vite përvojë pune profesionale;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekspit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (CAD, paketën Office);
- Njohje të gjuhës angleze e preferuar;
- Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës;

## Për plotësimin e një (1) pozite

**Titulli i punës: Teknik për mirëmbajtje elektrike/Elektromontues- (Numri i kryerësve 1)**

- **Vendi: Njësia Punuese "Shkabaj"**
- **Ndërmarrja: Ndërmarrja Publike Hidroekonomike "Ibër Lepenc" Sh.A**
- **Niveli i pages: 350 poena**

**Detyrat dhe përgjegjësite e punës:**

- Kujdeset për mirëmbajtjen dhe operimin e pajisjeve elektro-energetike në tërë hidrosistemin teknike siq janë:
  - o LP 10 kV, LP 35 kV, e që të dy llojet e largëpërquesve
  - o Rrjetin 0.4 kV për tërë hidrosistemin
  - o Transformator me kapacitete nga 50 kVA e deri 6.3 MVA
  - o Trafokthina dhe ndërprerësa 35kV
  - o Rele multifunksionale nëpër trafokthina 35kV, 10kV
  - o Transformator rrymor dhe të tensionit nëpër Stacione pompike
- Realizon urdhurat për evitimin e prishjeve, operimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve elektrike;
- Merr pjese ne riparime dhe i zbaton planet e riparimit;
- Paraqet me kohë kërkesat për furnizim me material të nevojshem si dhe me pjesë rezervë;
- E njofton me kohë udhëheqësin e drejtperdrejtë mbi gjendjen e pajisjeve elektrike në hidrosistem;
- Kryen edhe punë të tjera sipas urdhrit të udhëheqesit të drejtperdrejt, në kuadër të profesionit dhe aftësive të tij;
- Për punën e vet i përgjigjet dhe i raporton shefit të sherbimit të elektro-makinerisë dhe inxhinierit përkatës.

**Aftësitë dhe kualifikimet:**

- Së paku përgatitja e mesme shkollore teknike (dega elektro-energetikë);
- Përvojë të dëshmuar profesionale se paku 1 vit ne fushen relevante;
- I aftë për punë në lartësi dhe në nivel tensioni deri në 35kV;
- Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Aftësi për përbushje të detyrave dhe punëve nën presion.

## Për plotësimin e një (1) pozite

**Titulli i punës: Inxhinier i operimit, mirëmbajtës ndërtimore të objekteve hidroteknike në H.S. dhe mbrojtjes nga ujërat- (Numri i kryerësve 1)**

- **Vendi: Njësia Punuese "Shkabaj"**
- **Ndërmarrja: Ndërmarrja Publike Hidroekonomike "Ibër Lepenc" Sh.A**
- **Niveli i pages: 520 poena**

**Detyrat dhe përgjegjësite e punës:**

- Bashkë me shefin përpilon planin tekniko-investiv të mirëmbajtjes;
- Kontrollon punën e teknikëve për mirëmbajtjen e kanalit kryesore dhe sekondar me objekte dhe mbrojtje nga ujërat;
- Bën evidentimin në elaborate të çdo ndryshimit të zgjedhjes teknike të objektit të ekzekutuar;
- Kontrollon dhe udhëheq dokumentacionin teknik;

- Merr pjesë në hartimin e planit për mbrojtje të ujërave dhe mbrojtje nga përmbytja, si dhe organizon punët në atë drejtim;
- Kryen edhe punë tjera sipas urdhrit të shefit të shërbimit;
- Për punën e tij i përgjigjet shefit të shërbimit.

#### **Aftësitë dhe kualifikimet:**

- Edukimi universitar, Fakulteti i Inxhinierisë të Ndërtimit.
- Së paku 2 vite përvojë pune profesionale;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike (GIS, CAD dhe Office)
- Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës.

#### **Për plotësimin e një (1) pozite**

#### **Titulli i punës: Inxhinier për mirëmbajtjen e sistemit SCADA- (Numri i kryerësve 1)**

- **Vendi: Njësia Punuese "Shkabaj"**
- **Ndërmarrja: Ndërmarrja Publike Hidroekonomike "Ibër Lepenc" Sh.A**
- **Niveli i pages: 520 poena**

#### **Detyrat dhe përgjegjësите e punës:**

- Përgjegjës për mirëmbajtjen e sistemit SCADA lidhur me mirëmbajtjen, dizajnin e ardhshëm, zhvillimin dhe operimin e sistemit të SCADA/RTU si dhe ndërlidhjen e tij me pajisjet elektronike, energjetike, hidraulike dhe pulteve komanduese përgjatë hidrosistemit
- Merr pjesë në procesin e implementimit dhe testimit të sistemeve të SCADA, RTU.
- Siguron mirëmbajtjen e duhur të SCADA qendrore dhe jep mbështetje të rendit të parë.
- Siguron mirëmbajtjen e duhur të sistemeve të RTU dhe SCADA lokale nëpër ON dhe SP.
- Organizon gatishmërinë ditë e natë për veprim të menjëhershëm në rast të problemeve në SCADA, RTU.
- Mirëmban dokumentacionin e sistemit të SCADA dhe njohurinë e detaleve të softuer dhe harduer.
- Bënë rekomandime për përmirësimin dhe ekspansionin e sistemeve SCADA dhe mbështet veprimet e pajtuara.
- Mbështet procesin e mbledhjes së sistemeve dhe zhvillimin.
- Implementimi dhe testimi i sistemeve.
- Analizimi i viruseve dhe keqfunkcionimeve të sistemeve.
- Identifikimi i zbrazëtirave në performancen e sistemeve.
- Vlerësimi i nevojave të ardhshme.
- Mbështet procesin e mbledhjes së sistemeve dhe zhvillimin.
- Definon kërkesat për sistemet e reja dhe përmirësimin e sistemeve ekzistuese të SCADA.
- Siguron mirëmbajtjen e duhur të pajisjeve elektrike dhe telekomunikuese dhe jep mbështetje të rendit të parë për infrastrukturën elektrike dhe telekomunikuese.
- Definon mekanizmat e komunikimit dhe protokollet për shkëmbimin e të dhënavë me përdoruesit e sistemit.
- Kryen detyra tjera sipas kërkesës se udhëheqësit.
- Për punën e vet i përgjigjet dhe i raporton shefit të shërbimit.

### **Aftësitë dhe kualifikimet:**

- Edukimi universitar, Fakulteti Inxhinieri Elektrike (drejtimi elektronikë, automatikë ose telekom).
- Së paku 2 vite përvojë pune profesionale,
- Shkathtesi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtesi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtesi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (CAD, paketën Office);
- Shkathtesi në komunikim, planifikim të punës;
- Njohje të gjuhës angleze e preferuar.

### **Për plotësimin e një (1) pozite**

#### **Titulli i punës: Punëtor në Njësinë e mirëmbajtës së infrastrukturës - (Numri i kryerësve 1)**

- **Vendi: Komuna Zubin Potok**
- **Ndërmarrja: Ndërmarrja Publike Hidroekonomike “Ibër Lepenc” Sh.A**
- **Niveli i pages: 300 poena**

#### **Detyrat dhe përgjegjësите e punës:**

- Hartimi i planit të punëve të mirëmbajtjes dhe riparimeve për infrastrukturën për rrith digave dhe kanalit kryesor.
- Bashkëpunimi me ekipin për të përcaktuar prioritetet dhe frekuencën e punëve të mirëmbajtjes.
- Planifikimi dhe koordinimi i aktiviteteve ditore të mirëmbajtjes me ekipin e punëtorëve.
- Sigurimi që të gjitha punët janë të planifikuara dhe të koordinuara për të maksimizuar eficiencën dhe cilësinë.
- Drejtimi dhe mbikëqyrja e ekipit të mirëmbajtjes për të siguruar kryerjen e punëve në mënyrë të sigurt dhe efikase.
- Shpërndarja e detyrave dhe monitorimi i përmbushjes së tyre sipas standardeve të kërkua.
- Organizimi dhe kryerja e punëve të mirëmbajtjes rutinore për rruget, kanalet dhe strukturat ndihmëse për rrith digave.
- Sigurimi që të gjitha punët rutinore kryhen në përputhje me planin e miratuar dhe me standartet teknike.
- Përdorimi i pajisjeve dhe mjeteve të duhura për të kryer punët me cilësi dhe në kohë.
- Mbikëqyrja e mirëmbajtjes dhe riparimit të pajisjeve dhe mjeteve të përdorura për mirëmbajtjen e infrastrukturës.
- Përgatitja e raporteve të detajuara dhe rekomandimeve për veprimet e nevojshme.
- Dokumentimi i gjetjeve dhe përgatitja e raporteve për menaxhmentin mbi punët e kryera dhe situatat kritike

### **Aftësitë dhe kualifikimet:**

- Së paku përgatitja e mesme shkollore;
- Së paku 2 vjet përvojë pune;
- Shkathtesi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;

## Për plotësimin e dy (2) pozitave

### **Titulli i punës: Punëtor në Njësinë e mirëmbajtës së digave- (Numri i kryerësve 2)**

- **Vendi:** Komuna Zubin Potok
- **Ndërmarrja:** Ndërmarrja Publike Hidroekonomike “Ibër Lepenc” Sh.A
- **Niveli i pages:** 300 poena

### **Detyrat dhe përgjegjësite e punës:**

- Kryerja e punëve të mirëmbajtjes dhe riparimeve sipas planit të miratuar nga shefi apo kryepunëtori.
- Ndjekja e udhëzimeve dhe procedurave për të siguruar përbushjen e standardeve teknike dhe të sigurisë.
- Kujdesi dhe mirëmbajtja e pajisjeve dhe materialeve ndërtimore të përdorura në punë.
- Sigurimi që pajisjet janë në gjendje të mirë pune dhe të ruajtura në mënyrë të sigurt pas përdorimit.
- Ndihma në shpërndarjen e detyrave të punëtorëve të tjerë nën drejtimin e kryepunëtorit.
- Bashkëpunimi me ekipin për të siguruar përbushjen e detyrave në kohë dhe me cilësi të lartë.
- Monitorimi i punëve të kryera për të siguruar përputhshmërinë me standarde dhe specifikimet teknike.
- Raportimi i problemeve dhe parregullsive tek shefi apo kryepunëtori.
- Reagimi i shpejtë ndaj situatave emergjente dhe kryerja e riparimeve të nevojshme për të ruajtur integritetin e digës dhe infrastrukturës për rrith.
- Përdorimi i pajisjeve të duhura dhe teknikat e shpejta për riparime emergjente.
- Kryerja e të gjitha aktiviteteve të mirëmbajtjes dhe riparimeve në përputhje me protokollet e sigurisë dhe rregullat mjedisore.
- Zbatimi i masave mbrojtëse për të siguruar një mjeshtëri pune të sigurt. Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së shefit të shërbimit apo kyepunetorit;
- Për punën e vet i raporton dhe i përgjigjet shefit të shërbimit dhe kryepunetorit.

### **Aftësitë dhe kualifikimet:**

- Së paku përgatitja e mesme shkollore;
- Së paku 2 vjet përvjoë pune;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Aftësi për përbushje të detyrave dhe punëve nën presion;

## Për plotësimin e një (1) pozite

### **Titulli i punës: Shef i shërbimit të IT-së- (Numri i kryerësve 1)**

- **Vendi:** Prishtinë
- **Ndërmarrja:** Ndërmarrja Publike Hidroekonomike “Ibër Lepenc” Sh.A
- **Niveli i pages:** 600 poena

### **Detyrat dhe përgjegjësite e punës:**

- Menaxhimin e Zyrës;
- Menaxhimin mbi sistemet e TI-së;
- Menaxhimin mbi sigurinë për të gjitha aspektet e rrezikut që rrjedhin nga sistemet e TI-së;
- Menaxhimin e proceseve që kanë të bëjnë me të gjitha aplikacionet në ndërmarrje, të jashtme dhe të krijuara brenda ndërmarrjes;
- Menaxhimin mbi te drejtat dhe përgjegjësit e çdo përdoruesi në sistemet brenda ndërmarrjes;
- Menaxhimin nga rreziqet e brendshme dhe të jashtme në lidhje me sistemet e TI-së dhe lidhshmërinë me sistemet tjera;

- Menaxhimin e të gjitha proceseve që kanë të bëjnë me licensimin dhe marrjen e licencave për çdo aplikacion te përdorur në ndërmarrje;
- Zbatimin e te gjitha standardeve të TI-së, ligjeve dhe rregulloreve në fushën e TI-së;
- Organizimin e sisitemit për mbrojtjen e të dhënave personalë sipas ligjeve në fuqi;
- Ofron shërbime dhe përkrahje për të gjithë shfrytëzuesit e sistemeve dhe pajisjeve të TI-së;
- Dizajnon, implementon, administron dhe mirëmbanë rrjetet kompjuterike në kuadër të ndërmarrjes, duke përfshirë komunikimin e brendshëm, atë të jashtëm si dhe shërbimet e internetit;
- Ndërton, zhvillon dhe mirëmbanë infrastrukturen harduerike të servereve, sistemeve operative dhe aplikacioneve tjera në ndërmarrje;
- Ndërton, zhvillon dhe mirëmbanë bazën e të dhënave për të gjitha sistemet softuerike në kuadër të ndërmarrjes.
- Kryen edhe pune tjera sipas kërkesës së mbikëqyrësit.
- Për punën e tij i përgjigjet Drejtorit të Departamentit.

**Aftësitë dhe kualifikimet:**

- Edukimi universitar, Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, Teknologji Informative, Inxhinieri Elekrike dhe Kompjuterike;
- Së paku 3 vite përvojë punë profesionale ne sektorin e IT-së;
- Njohje të vertetuara të fushës së teknologjisë informative, rrjetave kompjuterike dhe menaxhimit te sistemeve informatike;
- Certifikime relevante te licensuara qe nderlidhen me poziten janë përparësi;
- Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Njohje të gjuhës angleze e preferuar.

**Për plotësimin e një (1) pozite**

**Titulli i punës: Inxhinier i ndërtimtarisë - (**Numri i kryerësve 1**)**

- **Vendi: Prishtinë**
- **Ndërmarrja: Ndërmarrja Publike Hidroekonomike “Ibër Lepenc” Sh.A**
- **Niveli i pages: 520 poena**

**Detyrat dhe përgjegjësite e punës:**

- Mbështet Shërbimet për planifikim, zhvillim dhe monitorim të projekteve për planifikim të mirëmbajtjes së strukturave te kanaleve të furnizimit me ujë në lidhje me strategjinë afatgjate operative për planifikimin e mirëmbajtjes së kanaleve të furnizimit me ujë;
- Mbështet Shefin e Shërbimit për planifikim dhe monitorim të projekteve për planifikim të mirëmbajtjes së kanaleve të furnizimit me ujë në përgatitjen e planeve të rregullta të mirëmbajtjes së sistemit, kanaleve-Kampadave të furnizimit me ujë, duke përfshirë tubacionet, rezervuarët, objektet ndarëse dhe stacionet e pompimit.
- Bashkërisht me stafin e mirëmbajtjes, dhe vetë bën vizitat në terren dhe incizion gjendjen e infrastrukturës së Hidrosistemit Iber-Lepenc.
- Përgatit planet e projekteve per renovime dhe rehabilitime te Hidrosistemit Ibër-Lepenc kujdeset per sigurin dhe cilësinë punimeve dhe strukturave.
- Përgatit planet e testimeve, analizave periodike të cilësisë së punimeve për të siguruar përpunim me standarde ndertimit dhe mjedisit.
- Punon në specifikimin e punimeve për tenderime për punët në kuadër të shërbimit;

- Zhvillon planet dhe projektet emergjente e reagimit emergjent për ngjarje të papritura, të tilla si shpërthime tubash, demtime kampadash ose incidente tjera ne strukturen e IL.
- Përgatit projekt dizajnet, planet e mirëmbajtjes si dhe planet e zëvendësimit te materialeve për të zgjatur jetëgjatësinë e aseteve.
- Siguron pajtueshmërinë me Ligjin, rregulloret mjedisore dhe të cilësisë së ujit.
- Përgatit dhe dorëzon raportet e rregullta javore dhe mujore tek Shefi i sherbimit.
- Ndihmon Shefin e Sherbimit për planifikim dhe monitorim të projekteve për performacen e infrastrukturës së Hidrosistemit Iber-Lepenc.
- Mbështet Shefin e Sherbimit për planifikim dhe monitorim të projekteve për vendosjen e aranzhmaneve efektive për bashkërendimin operativ me sektorët tjerë;
- Monitoron, propozon plane për performancën e hidrosistemit dhe furnizimit me ujë dhe si të jetë e nevojshme për funksionimin efikas të Drejtorisë;
- Për Punën e vet i raporton Shefit të Sherbimit për planifikim dhe monitorim të projekteve;
- Kryen detyra të tjera të cilat kërkohen nga Drejtori.

#### **Aftësitë dhe kualifikimet:**

- Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, drejtimi konstruktiv, Bechelor i Shkencave e deshirueshme inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose Master i shkencave;
- Së paku 3 vjet përvjohje pune;
- Njohje të thellë të industrisë së shërbimeve publike në nivel lokal dhe global.
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Autocad, Word, Excel, Poëer Point, Access, Internetit);
- Njohje të gjuhës angleze e prfesuar;
- Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës.

#### **Për plotësimin e një (1) pozite**

#### **Titulli i punës: Inxhinier i ndërtimtarisë- (**Numri i kryerësve 1**)**

- **Vendi: Prishtinë**
- **Ndërmarrja: Ndërmarrja Publike Hidroekonomike “Ibër Lepenc” Sh.A**
- **Niveli i pages: 520 poena**

#### **Detyrat dhe përgjegjësите e punës:**

- Mbështet Sherbimet për planifikim, Zhvillim dhe monitorim të projekteve për planifikim të mirëmbajtjes së strukturave te kanaleve të furnizimit me ujë në lidhje me strategjinë afatgjate operative për planifikimin e mirëmbajtjes së kanaleve të furnizimit me ujë;
- Mbështet Shefin e Sherbimit për zhvillim dhe menaxhim të projekteve për planifikim të mirëmbajtjes së kanaleve të furnizimit me ujë në përgatitjen e planeve të rregullta të mirëmbajtjes së sistemit kanaleve-Kampadave të furnizimit me ujë, duke përfshirë tubacionet, rezervuarët, objektet ndarëse dhe stacionet e pompimit.
- Bashkërisht me stafin e mirëmbajtjes, dhe vetë bën vizitat në terren dhe incizion gjendjen e infrastrukturës së Hidrosistemit Iber-Lepenc.
- Përgatit planet e projekteve per renovime dhe rehabilitime te Hidrosistemit Ibër-Lepenc kujdeset per sigurin dhe cilësinë punimeve dhe strukturave.

- Përgatit planet e testimeve, analizave periodike të cilësisë së punimeve për të siguruar përputhjen me standarde të ndertimit dhe mjedisit.
- Zhvillon planet dhe projektet emergjente e reagimit emergjent për ngjarje të papritura, të tillë si shpërthime tubash, demtime kampadash ose incidente tjera ne strukturen e IL.
- Punon në specifikimin e punimeve për tenderime për punët në kuadër të shërbimit;
- Përgatit projekt dizajnet, planet e mirëmbajtjes si dhe planet e zëvendësimit te materialeve për të zgjatur jetëgjatësinë e aseteve.
- Siguron pajtueshmërinë me Ligjin, rregulloret mjedisore dhe të cilësisë së ujit.
- Përgatit dhe dorëzon raportet e rregullta javore dhe mujore tek Shefi i sherbimit.
- Ndihmon Shefin e Sherbimit për zhvillim dhe menaxhim të projekteve për performancen e infrastrukturës së Hidrosistemit Iber-Lepenc.
- Mbështet Shefin e Sherbimit për planifikim dhe monitorim të projekteve për vendosjen e aranzhmaneve efektive për bashkërendimin operativ me sektorët tjera;
- Monitoron, propozon plane për performancën e hidrosistemit dhe furnizimit me ujë dhe si të jetë e nevojshme për funksionimin efikas të Drejtorisë;
- Për Punën e vet i raporton Shefit të Sherbimit për zhvillim dhe menaxhim të projekteve;
- Kryen detyra të tjera të cilat kërkohen nga Drejtori.

**Aftësitë dhe kualifikimet:**

- Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, drejtimi Hidro, Bechelor i Shkencave e deshirueshme inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose Master i shkencave;
- Së paku 3 vjet përvjoe pune;
- Njohje të thellë të industrisë së shërbimeve publike në nivel lokal dhe global.
- Shkathtesi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtesi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekondicioneve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtesi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Autocad, Word, Excel, Poëer Point, Access, Internetit);
- Njohje të gjuhës angleze e preferuar;
- Shkathtesi në komunikim, planifikim të punës.

**Për plotësimin e një (1) pozite**

**Titulli i punës: Inxhinier i Makinerisë- (Numri i kryerësve 1)**

- **Vendi: Prishtinë**
- **Ndërmarrja: Ndërmarrja Publike Hidroekonomike “Ibër Lepenc” Sh.A**
- **Niveli i pages: 520 poena**

**Detyrat dhe përgjegjësите e punës:**

- Mbështet Sherbimet për planifikim, Zhvillim dhe monitorim të projekteve për planifikim të mirëmbajtjes së paisjeve inxhinjerike te strukturave te Hidrosistemit te Iber-Lepencit përfshirë tubacionet, rezervuarët, objektet ndarëse dhe stacionet e pompimit sipas kualifikimit inxhinjerik që posedon.
- Mbështet Shefin e Shërbimit për zhvillim dhe menagjim
- të projekteve për planifikim të mirëmbajtjes së kanaleve të furnizimit me ujë në përgatitjen e planeve të rregullta të mirëmbajtjes së sistemit, kanaleve-Kampadave të furnizimit me ujë, duke përfshirë tubacionet, rezervuarët, objektet ndarëse dhe stacionet e pompimit sipas kualifikimit inxhinjerik që posedon.

- Përgadit plane të përcaktojë natyrën dhe standardet minimale të cilësisë për sigurimin dhe instalimin e sistemit Solar ne asetet ekzistuese te Iber-Lepenc-it;
- Përgadit plane të instalimit, përmirësimit të sistemit solar, ruajtja e fuqisë së besueshme, maksimizimi i prodhimit të energjisë diellore;
- Bashkërisht me stafin e mirëmbajtjes, dhe vetë bën vizitat në terren dhe incizion gjendjen e infrastrukturës së Hidrosistemit Iber-Lepenc.
- Përgatit planet e projekteve per renovime dhe rehabilitime te Hidrosistemit Ibër-Lepenc kujdeset per sigurin dhe cilësinë punimeve te paisjeve elektroenergetike te strukturave.
- Përgatit planet e testimeve, analizave periodike të cilësisë së punimeve për të siguruar përputhjen me standardet e ndertimit dhe mjedisit.
- Zhvillon planet dhe projektet emergjente e reagimit emergjent për ngjarje të papritura, të tilla si shpërthime tubash, demtime asetesh ose incidente tjera ne strukturen e IL.
- Përgatit projekt dizajnet, planet e mirëmbajtjes si dhe planet e zëvendësimit te materialeve për të zgjatur jetëgjatësinë e aseteve.
- Koordinon punën e tij me inxhinierin për punë të elektros dhe me personelin tjetër në DPZH, me qëllim të funksionimit sa më të suksesshëm të instalimeve dhe pajisjeve elektromakinerike;
- Punon në specifikimin e punimeve për tenderime për punët në kuadër të shërbimit;
- Të përcaktojë natyrën dhe standardet e cilësisë për sigurimin dhe instalimin e sistemit Solar
- Përgadit plane të instalimit per Solar, përmirësimit të sistemit solar, ruajtja e fuqisë së besueshme, maksimizimi i prodhimit të energjisë diellore
- Siguron pajtueshmërinë me Ligjin, rregulloret mjedisore dhe të paisjeve te cilësisë së ujit.
- Përgatit dhe dorëzon raportet e rregullta javore dhe mujore tek Shefi i sherbimit.
- Ndihamon Shefin e Sherbimit për planifikim dhe monitorim të projekteve për performacen e infrastrukturës së Hidrosistemit Iber-Lepenc.
- Mbështet Shefin e Sherbimit për zhvillim dhe menagjim të projekteve për vendosjen e aranzhmaneve efektive për bashkërendimin operativ me sektorët tjera;
- Monitoron, propozon plane për performancën e hidrosistemit dhe furnizimit me ujë dhe si të jetë e nevojshme për funksionimin efikas të Drejtorisë;
- Për Punën e vet i raporton Shefit të Sherbimit Sherbimit për planifikim dhe monitorim të projekteve;
- Kryen detyra të tjera të cilat kërkohen nga Drejtori.

#### **Aftësitë dhe kualifikimet:**

- Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike-Termoenergetikë dhe Energji të Ripërtëritshme, Bechelor i Shkencave- e deshirueshme inxh.dip. Makinerisë ose Master i shkencave
- Së paku 3 vjet përvojë pune profesionale;
- Njohje të thellë të industrisë së shërbimeve publike në nivel lokal dhe global.
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekondimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Autocad, Word, Excel, Power Point, Access, Internetit);
- Njohje të gjuhës angleze e preferuar;
- Aftësi për përbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës.

## **Procedura për aplikim për të gjitha pozitat:**

### **Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim:**

- Aplikacioni i cili mund të shkarkohet nga uebfaqja e Kompanisë ([www.iber-lepenc.org](http://www.iber-lepenc.org));
- Një C.V. e detajuar (preferohet në shablonin Europass);
- Kopja e letërnjoftimit ose pasaportës;
- Letër motivimi (maksimum 500 fjalë);
- Kopjet e diplomave mbi kualifikimin arsimor, nostrifikimin për diplomat e marra jashtë vendit;
- Kopjet e certifikimeve përkatëse;
- Dëshmi për përvojën e punës: Kontratën apo vërtetim i lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë;
- Certifikatë nga gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe që nuk është i dënuar për kryerjen e ndonjë vepre penale (jo më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit).
- Per punën e vet i raporton dhe i pergjigjet shefit të sherbimit dhe kryepunetorit.

Konkursi mbetët i hapur pesëmbdhjetë (15) ditë kalendarike, afati i fundit për aplikim është deri me: **27.01.2025, ora 16:00h CET.**

Afati për dorëzimin e aplikacioneve fillon me datë: **13.01.2025** dhe përfundon me **27.01.2025** në ora **16:00.**

Aplikacionet mund të merren në web-faqen zyrtare të Ndërmarrjes [www.iber-lepenc.org](http://www.iber-lepenc.org).

Aplikacionet e plotësuara së bashku me kopje të dëshmive të këruara sipas konkursit dorëzohen në mënyrë elektronike vetëm në email adresën: [burimet.njerezore@iber-lepenc.org](mailto:burimet.njerezore@iber-lepenc.org)

**Aplikacioni së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur duhet të jetë në formatin PDF, në të kundërtën çdo aplikacion jashtë këtij formati nuk do të pranohet.**

**Vërejtje:** Kandidatët me dokumentacion të pakompletuar, të paplotësuar, jo-adekuat dhe jashtë afatit të konkurrimit, do të refuzohen. Do të kontaktohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara dhe përfshihen në listën e ngushtë. Me kandidatët e zgjedhur do të nënshkruhet Kontrata e punës pas sjelljes së certifikatës mjekësore.

**Kryeshef Ekzekutiv**

**Faruk Mujka**

---



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE “IBËR - LEPENC” SH.A.

HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE “IBËR - LEPENC” J.S.C.

VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE “IBËR - LEPENC” D.D.

Sheshi ”Bil Clinton” Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar ”Bil Clinton” Br.13 Priština, Kosovo  
